

L. PORADECI – Gjuha e zjarrtë

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

Nga mund ta ketë huazuar titullin e poezisë së vet Lasgushi? Argumento mendimin.

**Cili është kuptimi i togfjalëshit gjuha e zjarrtë, siç del nga përmbajtja e poezisë?
Çfarë karakteri merr poezia prej kuptimit të këtij togfjalëshi?**

Cilat janë cilësitë e gjuhës së zjarrtë, sipas vargjeve:

*O gjuhë-e shenjtëruar, o mall me shpirtin plot.
O vetëtim' e qjellit që fërfëllon me flakë,
O djellë-i llaftaruar që ndrin si pikë lot.*

Gjeni dhe komentoni lidhjen që vendoset midis vargut të parë dhe të dytë (bazohuni tek kuptimi i fjalëve pikë loti):

*O djellë-i llaftaruar që ndrin si pikë lot.
Si pikë lot e ndritur po ndrij në rreze tuaj.*

Vargjet e poezisë përcjellit tek lexuesi, veç të tjerash edhe dhimbje. Nga e ka burimin kjo dhimbje?

Si pikë lot e ndritur po ndrij në rreze tuaj.

Vargjet e poezisë përcjellit tek lexuesi, veç të tjerash edhe dhimbje. Nga e ka burimin kjo dhimbje?

*Po ndrij e papandehur po qaj pak e nga pakë
Sepse prej botës suaj kam mbetur kaq i huaj...*

-shënime-

Gjeni kuptimin e fjalëve i ndrydhur, i shkretë, në vargun e mëposhtëm:

Kam mbetur kaq i huaj, dh'i ndrydhur edh'i shkret!

Jepni një sinonim kontekstual të fjalës çudit duke u mbështetur në kuptimin e vargut:

Prej ligjëratës që më çudit, o zjarr!

Pse Lasgushi përdor karakterizime të tilla për veten e vet (për poetin): “mjerush” e “dyke vuar” (ndërkohë që jemi mësuar poetin ta përfytyrojmë madhështor dhe t'i vemë karakterizime analoge)?

Do vi! Do të vi pranë mjerush e dyke vuar

Në cilat vargje duket shndërrimi, transformimi i kësaj gjuhe të zjarrtë në ligjërim poetik? Pra në cilat vargje duket lindja e poezisë?

Ndajeni poezinë në dy pjesë dhe argumentoni këtë ndarje.

Përfundimisht cili është kuptimi i titullit të poezisë “Gjuha e zjarrtë”?

Krahasoni cilësitë e gjuhës poetike me ato të gjuhës shqipe (gjejini ato në dy pjesët e poezisë).

-shënime-

Cilat janë mënyrat e shfaqjes së një gjuhe? Gjeni vargjet ku shfaqen ato.

Ka ndonjë arsye që L. Poradeci nuk ka përdorur normën letrare lexoj, por fjalën në dialekt këndoj?

Ç'kuptim ka krahasimi i vargut:
Posi një kraharuar ti dhemb, o-Gjuhë e zjarrtë.

Cili është kuptimi i vargut (e pjesës së nënvizuar):
O gjuhë e zemrës sime, o mos-e-kuvenduar.
Cilat vagje nga letërsia e traditës ju kujtojnë?

Bëni skemën e rimës së poezisë dhe vëreni veçantinë e kësaj skeme.

Vargu i fundit i poezisë së Lasgushit: *O gjuhë e zemrës sime, o mos-e-kuvenduar*, na kujton vargjet e Naimit: *E ku shkruhenë në kartë / Fjalët e gjuhës së zjarrtë.*

Argumentoni në formën e një eseje mendimin e L. Poradecit për cilësitë e veçanta të kësaj gjuhe, që e bëjnë atë mos-të-kuvenduar.